



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës**

V E N D I M

Nr. 90/1, Datë 07.10.2008

**Për një korrigjim në vendimin nr. 90 Datë 07.10.2008
“Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e
konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.10.2008 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një korrigjim në vendimin nr. 90, Datë. 07.10.2008 “Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike”.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Neni 129 i ligjit nr. 8485 Dt. 12.5.1999 “Kodi i Procedurave administrative”.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

V Ë R E N S E:

Gjatë zbardhjes së vendimit nr. 90 datë 07.10.2008 të paraqitur për nënshkrim pranë Komisionit të Konkurrencës, ka pasur një gabim teknik në paragrafin e

dytë, të dispozitivit të vendimit duke mos hequr pikën 1 të tij, siç u vendos nga Komisioni gjatë diskutimit nen për nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenet 24, shkronja d, neni 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Neni 129 i ligjit nr. 8485 Dt. 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me nismën e vet:

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 90 Datë 07.10.2008 “Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike”, të korrigohet duke fshirë Pikën 1 të Paragrafit të dytë të dispozitivit të këtij vendimi si dhe duke rregulluar numërtimin përkatës.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R